

KPK shkarkon gjyqtarin Aleks Nikolli

Gjyqtari i Apelit të Shkodrës Aleks Nikolli u shkarkua nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pasi nuk arriti të justifikonte pasurinë.

Autor: [Vladimir Karaj](#) | BIRN | Tiranë



Gjyqtari Aleks Nikolli pas vendimit të KPK. Foto:Vladimir Karaj/BIRN

Gjyqtari i Apelit të Shkodrës Aleks Nikolli u shkarkua të hënën nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pasi nuk arriti të justifikonte pasurinë. Nikolli, i cili u hetua nga Komisioni vetëm në një prej kriterëve të procesit të vetingut, është ndërkohë nën hetim nga Struktura e Posaçme Anti Korrupsion, SPAK, për korrupsion, si një nga tre gjyqtarët që vendosi zbutjen e dënimit të Dritan Dajtit- i dënuar për vrasjen e 4 policëve, Dëshmorë të Atdheut.

Gjatë seancës dëgjimore ndaj Nikollit që zgjati 8 orë, atij iu vunë në dukje probleme të shumta të pasurisë, të cilat i kundërshtoi në parashtrimet e tij.

Gjatë seancës dëgjimore Komisioni konstatoi pamundësi financiare për ndërtimin e një shtëpie trekatëshe në fshatin Ishull Shëngjin të Lezhës, ku gjyqtari Aleks Nikolli rezultoi si pronar i katit të dytë me sipërfaqe 147.8 m². Sipas KPK nga analiza financiare rezultoi se Nikolli nuk mbulonte me të ardhura të ligjshme 6.2 milion lekë të investimit.

Komisioni ngriti po ashtu dyshime për veprime fiktive lidhur me blerjen dhe shitjen e një njësie shërbimi 12 m² në qytetin e Lezhës. Nga hetimi ka rezultuar se Nikolli e ka blerë këtë pasuri në vitin 2008 për vlerën 1.2 milionë lekë dhe i'a ka shitur në shumën 3.2 milionë lekë vjehtit të ardhshëm në vitin 2009. Probleme po ashtu u gjetën edhe për një kontratë për blerjen e një apartamenti në Tiranë.

Nikolli i kundërshtoi gjetjet e Komisionit në një mbrojtje të gjatë për rreth 6 orë. Ai këmbënguli se pasuria e tij ishte modeste dhe se kishte vetëm apartamentin në fshat. “Kam qenë gjyqtar mbi mesataren dhe kam dashur t’u ngjaj gjyqtarëve evropianë. Në gjithë statistikat kam qenë në top-listë. Pavarësisht kësaj, nuk më ka përfillur askush, edhe në Apel më emëruan se kishte vende bosh,” tha ai para KPK-së.

Trupi gjykues që kreu procesin e rivlerësimit për gjyqtarin Alks Nikolli drejtohej nga Brunilda Bektashi kryesuese, Olsi Komici relator dhe Lulzim Hamitaj anëtar. Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar ishte e pranishme Elka Ermenkova.

Nikolli është diplomuar për drejtësi në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër dhe nga viti 2001 deri në vitin 2004 ai ka mbaruar studimet në shkollën e Magjistraturës. Në vitin 2015, Nikolli ka marrë titullin “Doktor shkencash” në Universitetin Europian të Tiranës. Nga viti 2004 deri në vitin 2016 ka shërbyer si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nga viti 2016 si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër.



RRETH AUTORIT

[Vladimir Karaj](#)

Vladimir Karaj është redaktor i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri, BIRN Albania.